



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1422 Prot.

Tiranë, më datë 23.09.2021

VENDIM  
Nr. 578, datë 23.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.09.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike në kuadër të projektit me objekt “*Projekti i restaurimit në Xhaminë e lagjes Varosh në Kalanë e Ndroqit, Tiranë*”, monument kulture i kategorisë së I-rë, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjektin të licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike në kuadër të projektit me objekt “*Projekti i restaurimit në Xhaminë e lagjes Varosh në Kalanë e Ndroqit, Tiranë*”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Rezultati i Sondazhit arkeologjik të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

